



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

---

**Seanca Plenare**

Seanca nr.2004/05

Prishtinë, më 17 mars 2004, në orën 10:15

Ndërtesa e Kuvendit, Salla e seancave plenare.

**PROCESVERBAL**

Seancën e kryesoi Nexhat DACI, kryetar i Kuvendit, kurse bashkëkryesues ishte Bajram Kosumi, anëtar i Kryesisë.

**Kryetari** konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 85 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryesia e Kuvendit ia kishte propozuar Kuvendit këtë

**REND DITE:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme;
3. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për tregti me naftë dhe derivate të saj;
4. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për kinematografi;
5. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për transportin e materieve të rrezikshme;
6. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për materialin fidanor;
7. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për ndërmarrjet;
8. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për veprimtaritë hoteliere dhe turistike;
9. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për parkun kombëtar "Bjeshkët e Nemuna";
10. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për energjinë;
11. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për rregullatorin e energjisë;
12. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për energjinë elektrike;
13. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për njësit matëse;
14. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për standardizim;
15. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për marrëveshjet ndërkombëtare financiare.

Para se të miratohej rendit i ditës, kryetarët e grupeve parlamentare kërkuan fjalën për të diskutuar lidhur me të.

**Sabri Hamiti**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, shtroi çështjet e sigurisë së qytetarëve të Kosovës. Ai përmendi sulmin me granatë dore në rezidencën e kryetarit të Kosovës, plagosjen e një të riu serb në rrethinën e Prishtinës dhe mbytjen e tre fëmijëve shqiptarë nga fshati Çabër në lumin Ibër të ndjekur nga serbët. Të gjitha këto tregojnë se është një trend dramatik i keqësimit të gjendjes së sigurisë për të cilin Kuvendi duhet ta jep një mesazh të fortë kundër këtyre zhvillimeve. Organet përgjegjëse të fushës së sigurisë duhet të sillen në nivelin e përgjegjësive që kanë. Për të rritur shkallën e sigurisë së brendshme, ai kërkoi që përgjegjësit e kësaj fushe të barten tek SHPK-ja. Duke marrë parasysh zhvillimin e ngjarjeve, Kuvendi në njërin nga seancat e ardhshme duhet të hapë diskutimin për çështjet e sigurisë.

**Arsim Bajrami**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, shprehu pakënaqësinë lidhur me zhvillimet e fundit të sigurisë në Kosovë. Këto zhvillime, shtoi ai kanë një tendencë për të krijuar një imazh negativ për Kosovën dhe për ta destabilizuar atë. Ne e gjuajmë sulmin që kanë ndodhur ndaj rezidencës së kryetarit të Kosovës dhe kërkujmë nga organet përgjegjëse ta zbulojnë kryesin e tij. Jemi të brengosur me zhvillimet e fundit në Mitrovicë të cilat janë jashzakonisht shqetësuese. Kjo nuk është vetëm një kriminalitet ordiner që vjen nga jashtë, por është një mesazh ndaj Kosovës dhe qytetarëve të saj që ka për qëllim futjen e pasigurisë dhe të frikës.

Gjuajmë plagosjen e një serbi në Çagllavicë, por e kundërshtojmë edhe metodën e minoritetit serb për bllokimin e rrugëve.

Këto akte duken të natyrës kriminale, por në esencë e kanë prapavinë politike përmes së cilës dëshirojnë të dërgojnë një mesazh tek opinioni publik ndërkombëtar për gjendjen e sigurisë në Kosovë dhe ta pengojnë realizimin e standardeve.

Ai propozoi që Kuvendi në seancën e ardhshme të diskutojë për gjendjen aktuale të sigursië në Kosovë, në të cilën duhet të ftohen përfaqësuesit e UNMIK-ut, përgjegjës për fushën e sigurisë, kryetari i Kosovës dhe kryeministri.

**Bujar Dugolli**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, shprehu shetësimin lidhur me zhvillimet e fundit në fushën e sigurisë. Prej seancës së kaluar kanë ndodhur një varg sulmesh, shtoi ai si: atentati ndaj ministrit Et'hem Çeku, hudhja e granatës në rezidencën e kryetarit të Kosovës, hudhja e tre fëmijëve në lumin Ibër, vrasja e babait të ushtarit të lirisë, Avni Elezit, plagosja e një serbi si dhe bllokimi i rrugëve nga pakica serbe, janë përpjekje për ta destabilizuar Kosovë.

Kemi treguar gatishmërinë tonë për të dhënë kontributin në përmirësimin e fushës së rendit, të drejtësisë dhe të sigurisë përmes bartjes së kompetencave në SHPK-në dhe TMK-në, të cilat janë të gatshme ta bëjnë sigurimin e brendshëm të Kosovës.

Ai propozoi që Kuvendi në seancën e ardhshme të diskutojë për çështjet e sigursië në Kosovë, në të cilën duhet të ftohen edhe përgjegjësit e pranisë ndërkombëtare në Kosovë, të kësaj fushe.

**Kryetari** tha se i përkrah diskutimet e kryetarve të grupeve parlamentare lidhur me zhvillimet e fundit. Ai në emër të Kuvendit dhe të qytetarëve të Kosovës shprehu

shqetësimet e mëdha për sulmin kundër kryetarit të Kosovës, mbytyjes së tre fëmiëve dhe plagosjes së një të riu të përkatësisë serbe.

Është brengë e përgjithshme, ngase para se të zbulohen kryesit e veprave kriminale po bllokohen rrugët kryesore të vendit dhe si pasojë e tillë po denohet shumica e qytetarëve të Kosovës.

Çështjet e sigurisë në Kosovë do të diskutohen në njërin nga seancat e ardhshme.

## 1. Miratimi i rendit të ditës.

**Kryetari** kërkoi të hiqet nga rendi i ditës P/ligji për kinematografinë me arsyetim se këtë e kanë kërkuar sponzoruesi i P/ligjit, përkatësisht Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Komisioni Funkcional i Kuvendit.

**Sabri Hamiti**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, kërkoi të hiqet nga rendi i ditës shqyrtimi i P/ligjit për parkun kombëtar "Bjeshkët e Nemuna".

**Bujar Dugolli** tha se Grupi Parlamentar i AAK-së nuk pajtohet të hiqet nga rendi i ditës shqyrtimi i P/ligjit për parkun kombëtar "Bjeshkët e Nemuna".

**Arsim Bajrami** tha se Grupi Parlamentar i PDK-së është kundër heqjes së P/ligjit për parkun kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" nga rendi i ditës.

**Lirak Çelaj** tha se P/ligji për kinematografinë të shtyhet për seancën e ardhshme me arsyetim se janë paraqitur shumë vërejtje serioze në të, të cilat Komisioni Funkcional duhet t'i shqyrtojë.

**Bajram Kosumi** tha se kërkesa e kryetarit të Grupit Parlamentar të LDK-së për heqjen e P/ligjit për parkun kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" nuk është e arsyetuar dhe si e tillë nuk mundet të përkrahet.

**Naim Maloku** tha se Komisionit për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor i ka arritur një peticion me 502 nënshkrime nga banorët e atij rajoni si dhe kërkesa e kryetarit të komunës së Pejës që P/ligji për parkun kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" të tërhiqet nga procedura e shqyrtimit. Komisioni nuk ka ndonjë qëndrim unik lidhur me këto kërkesa. Ai shprehu qëndrimin e tij se P/ligji duhet të shqyrtohet, ndërsa vërejtjet e parashtruara mund të përfshihen në p/ligj gjatë amendamentimit të tij.

**Fatmir Sejdiu** tha se e përkrah propozimin e kryetarit të Grupit Parlamentar për heqjen e P/ligjit për parkun kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" nga rendi i ditës me arsyetim se vërejtjet parashtruara në këtë P/ligj, sponzoruesi duhet t'i përfshijë në pjesën normative të tij.

**Tomë Hajdaraj**, në emër të Komisionit për Bujqësi dhe Zvillim Rural, i bëri një vështrim P/ligjit dhe propozoi të formohet një grup i profesionistëve për ta haruar një P/ligj të ri për normimin e kësaj materie.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votë propozimin për heqjen nga rendi i ditës P/ligjin për kinematografinë dhe rezultati ishte si vijon:

Për-----29.

**Kryetari** konstatoi se Kuvendi nuk e miratoi propozimin për heqjen e P/ligjit për kinematografinë nga rendi i ditës.

**Kryetari** e hodhi në votë propozimin e Grupit Parlamentar të LDK-së për shtyerjen e shqyrtimit të P/ligjit për parkun kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" dhe rezultati ishte si vijon:

Për-----42.

**Kryetari** konstatoi se Kuvendi e miratoi propozimin e Grupit Parlamentar të LDK-së për shtyerjen e shqyrtimit të P/ligjit për parkun kombëtar "Bjeshkët e Nemuna".

## **2. Miratimi i procesverballit të seancës së mëparshme.**

Procesverbali i seancës së mëparshme u miratua me vërejtjen e Sabri Hamitit se në transkript duhet të evidencohet edhe diskutimi për enklavat.

## **3. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për tregti me naftë dhe derivate të saj.**

**Kryetari** i informoi deputetët e Kuvendit për raportet dhe për rekomandimet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit Funkcional për këtë p/ligj. Ai i hodhi në votë amendamentet e Komisionit për Tregti dhe Industri, të koalicionit "Kthimi" dhe të deputetit Bedri Selmani, veç e veç.

**Kuvendi**, me shumicë votash, i miratoi këto amendamente: 2, 3a, 4, 5a, 6, 7a, 9, 10, 11, 13, 14, 14a, 18a, 20, 21, 23, 26, 27, 28, 29a, 30, 30a dhe 34a, ndërsa nuk i miratoi amendamentet: 1, 5b, 8, 12, 13, 15, 17, 18, b, 19, 22, 25, 29b, 31, 32, 33, 34b-c dhe 35.

**Kryetari** e hodhi në votë P/ligjin në tërësi dhe rezultati ishte si vijon:

Për-----shumica;

Kundër-----2;

Abstenime-----0.

**Kryetari** konstatoi se Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, e miratoi Ligjin për tregti me naftë dhe derivate të saj.

### **Kryetari dha pauzë njëorshe.**

Pas pauzës seancën e kryesoi **Bajram Kosumi**, anëtar i Kryesisë.

Kryesuesi tha se Kuvendi e ndërpreu seancën e rregullt për shkak të zhvillimeve dramatike në Mitrovicë, duke theksuar se Kuvendi do ta përcjell situatën aktuale dhe do të silllet sipas nevojave, zhvillimeve dhe përgjegjësive të tij.

Ai tha se të gjitha grupet parlamentare janë pajtuar ta miratojnë këtë

## **DEKLARATË**

### **LIDHUR ME ZHVILLIMET E 16 DHE TË 17 MARSIT 2004 NË MITROVICË**

- Kuvendi i Kosovës shpreh indinjatë të thellë dhe mospajtim me zhvillimet e sotme dramatike në Mitrovicë dhe për gjendjen e sigurisë të krijuar atje.
- Kuvendi i Kosovës shpreh mospajtim me pavendosmërinë e UNMIK-ut për të krijuar sigurinë e qytetarëve të Kosovës.
- Tolerimi i strukturave paralele serbe dhe i bandave kriminale që nxisin dhe vrasin qytetarët e Kosovës është politikë e gabuar që do ta destabilizojë Kosovën.
- Ftojme krerët e institucioneve demokratike të Kosovës dhe krerët të UNMIK-ut dhe të KFOR-it të takohen urgjentisht dhe t'i marrin masa e nevojshme për qetësimin e gjendjes dhe ta informojnë Kuvendin e Kosovës me të dhënat të sakta për situatën e krijuar dhe për masat e ndërmarrura.
- Ftojme KFOR-in t'i zhblllokojë rrugët në brendësinë e Kosovës dhe t'i kontrollojë në mënyrë rigorozë kufijtë e Kosovës, në mënyrë që të pamundësohet hyrja e bandave kriminale nga Serbia në territorin e Kosovës dhe veprimi i tyre.
- Institucionet e Kosovës dhe populli i saj nuk do të tolerojnë veprimin e mëtejshëm të strukturave paralele dhe të bandave vrasëse në Mitrovicë e gjetiu në Kosovë.

Kryesuesi e ndërpreu seancën plenare në orën 14:15 minuta.

### **Vazhdim i seancës më 18 mars 2004, në orën 11:00**

**Kryetari**, në emër të Kuvendit të Kosovës, u shprehu ngushllime të gjitha familjeve të të varurve gjatë protestave së këtyre ditëve.

Ai i ftoi deputetët e Kuvendit për një minutë heshtje, në shenjë nderimi për të gjithë të varrët gjatë dy-tri ditëve të fundit.

Qëndrimi i Kuvendit është se rinia dhe qytetarët e Kosovës të mos protestojnë në rrugë, por t'i kthehen punës dhe jetës normale, kurse shkaqet që shpien deri te shpërthimi i

kësaj revolte, t'ua lënë institucioneve dhe subjekteve politike të Kosovës t'i zgjidhin në mënyrë institucionale, në bashkëpunim me bashkësinë ndërkombëtare.

Ai i ftoi përfaqësuesit e grupeve parlamentare t'i paraqesin qëndrimet e tyre për normalizimin e situatës në vend.

**Sabri Hamiti**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, tha se ngjarjet tronditëse që kanë ndodhur dje, duke filluar në Mitrovicë dhe më vonë janë paraqitur në gjithë Kosovën, kanë pasur për motiv reagimin ndaj mbutjes së tre fëmijve në Çabër. Nga protestat e qeta kanë kaluar në konfrontime dhe për pasojë ka pasur dhjetra të vdekur dhe qindra të plagosur. Protestat e dhunëshme nuk ofrojnë zgjidhje politike për Kosovën. Çështjet fundamentale nuk mund të zgjidhen në këtë formë dhe nuk është koha që ato të vazhdojnë. Duhet të ulen tensionet dhe idetë të kthehen dhe të realizohen në mënyrë institucionale.

Ndodhitë e këtyre ditëve janë një sprovë për institucionet e Kosovës edhe për institucionet e bashkësisë ndërkombëtare që janë të pranishme në Kosovë. Nga kjo sprovë ato duhet të nxjerrin mësim duke e studjuar ambientin e Kosovës së ditëve të sotme.

Institucionet e Kosovës dhe ato të UNMIK-ut duhet t'i ridefinojnë raportet ndërmjet veti. Ai ridefinim duhet të bëhet sa më shpejt dhe të jetë produktiv për zhvillimet e ardhshme në Kosovë.

**Arsim Bajrami**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, tha se shpreh shqetësimet e thella për gjendjen e krijuar, këto ditë, në Kosovë dhe i thërrasin të gjithë qytetarët e Kosovës të vetëpërbahen, të kontribuojnë në qetësimin e situatës dhe problemet të zgjidhen në mënyrë institucionale.

Ne i gjykojmë të gjitha aktet e dhunës, të cilat cenojnë sigurinë individuale dhe pasurinë e qytetarëve të Kosovës.

Ngjarjet e këtyre ditëve janë si pasojë e problemeve të akumuluar dhe realizimit të ngadalshëm të misionit të UNMIK-ut dhe të mosushtimit të pushtetit të tij në tërë territorin e Kosovës.

UNMIK-u nuk i ka ndërmarrë masat e nevojshme për parandalimin e një revolte të pakontrolluar, nuk ka siguruar integritetin territorial të Kosovës duke lejuar lëvizjen e lirë të strukturave militare dhe paramilitare serbe në Kosovë.

Është koha që institucionet e Kosovës të hapin një debat me UNMIK-un për ridefinimin e pozicioneve. Për të realizuar këtë janë dy mundësi: E para, UNMIK-u të sigurojë integritetin territorial të Kosovës dhe të mundësojë lëvizjen e lirë për të gjithë qytetarët. E dyta, UNMIK-u në mënyrë të pashtyeshme të fillojë bartjen e të gjitha përgjegjësive tek institucionet e Kosovës.

Institucionet e Kosovës duhet ta koncipojnë një strategji nacionale për tri çështje kryesore: a) për vendosjen e ligjit në Kosovë, për sigurimin e rendit dhe të qetësisë; b) hartimin e një programi nacional për arritjen e standardeve për Kosovën dhe c) për finalizimin e sukseshëm të misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë.

Kuvendi duhet ta diskutojë dhe miratojë këtë strategji, e cila do t'i mbante proceset politike nën kontroll.

Ne angazhohemi për integritetin e minoritetit serb, por edhe UNMIK-u duhet të bëjë presion që ata ta luajnë rolin konstruktiv dhe të integrohen në institucionet e Kosovës.

Njohja e pavarësisë së Kosovës do t'i eliminonte të gjitha problemet ndëretnike në Kosovë, por edhe në rajon.

**Ramush Haradinaj**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, tha se Kuvendi dhe institucionet e tjera të Kosovës duhet të përgjigjen se çka ka ndodhur këto ditë në Kosovë? Ngjarja tragjike e mbyetjes së tre fëmijve në Çabërr dhe zhvillimet që pasuan edhe me dhunë meritojnë një vlerësim dhe analizë serioze.

Revolta qytetare që u manifestuar përmes këtyre protestave gjatë këtyre ditëve është kundër status quos.

Në këto rrethana janë dy çështje themelore që duhet pasur parasysh; a) A mundet Kuvendi i Kosovës, sot, krahas thirrjes për qetësimin e situatës, t'i premtojë popullit se do t'i kryejë obligimet e veta para elektoratit? dhe b) Sa i përket bashkëpunimit me bashkësinë ndërkombëtare, duhet të jemi më dinjitoz në mbrojtjen e interesave tona. Nuk duhet çdo herë dhe në çdo kohë vetëm të presim se çka na thonë partnerët tanë ndërkombëtarë.

Nga këto ngjarje duhet të nxjerrim mësim dhe institucionet vendore, të jenë më vetëkritikë për përgjegjësit që i kanë.

Mungesa e mekanizmave për mbrojtjen e rendit ka mundësuar të ndodhë edhe huliganizmi në rrugët e Kosovës.

AAK-ja i fton edhe forcat e tjera politike për bashkëpunim që t'i shpien proceset politike përpara.

**Nafije Gash**, në emër të Grupit Parlamentar të komuniteteve tjera, tha se janë të prekur me zhvillimin e ngjarjet të këtyre ditëve dhe u shprehin ngushllime familjeve të të vrarëve. Ajo apeloi tek qytetarët e Kosovës për uljen e tensioneve dhe të japin kontributin e tyre për normalizimin e situatës dhe zgjidhjen e problemeve në mënyrë institucionale. Ajo i denoi bllokimin e rrugëve, nxitësit dhe kryesit e akteve të dhunëshme.

**Hilmo Kandiç** tha se kërkesat e qytetarve të Kosovës janë të arsyeshme, ngase misioni i UNMIK-ut po tregohet i paafte, përkatësisht po punon me kritere dyfishta, varësisht nga përkatësia etnike e qytetarëve të Kosovës.

Është koha e fundit që UNMIK-u të fillojë barjtjen e kompetencave tek institucionet e Kosovës.

SDAK e denon dhunën dhe të gjitha incidentet që kanë ndodhur gjatë këtyre ditëve në Kosovë. Jemi të zhgënjyer me sjelljet e UNMIK-ut lidhur ngjarjet e fundit.

U shrehim ngushllime familjeve të të vrarëve, gjatë këtyre ditëve, të cilët kanë shrehur pakënaqësitë e arsyeshme me sjelljet e UNMIK-ut.

Ne e ftojmë popullin shqiptar, shumicë në Kosovë, të përmbahet ndaj provokimeve të bashkësisë serbe dhe një pjese të UNMIK-ut dhe t'ua mundësojnë forcave të rendit t'i lirojnë rrugët dhe ta kthejnë rendin dhe qetësinë.

## Vazhdim i seancës më 25 prill 2004.

Rendi i punës:

### Gjendja aktuale në Kosovë.

**Kryetari** i bëri një vështrim zhvillimit të ngjarjeve të 17 dhe 18 marsit 2004, të cilat shtoi ai duhen të analizohen dhe të gjenden kahje për tejkalimin e situatës në të mirë të gjithë qytetarëve të Kosovës.

Dhuna, si metodë dhe mjet, për realizimin e kërkesave është e palejueshme dhe e padobishme për shoqërinë tonë, kur janë të zgjedhura institucionet demokratike.

Kuvendi duhet njëzëri t'i denojë përdorimin e dhunës gjatë këtyre protestave, sulmet mbi popullsinë serbe dhe të ashkalive si dhe djegien e shtëpive, të kishave dhe të objekteve të tjera.

I denojmë sulmet ndaj pjestarëve të policisë së UNMIK-ut, KFOR-it dhe automjeteve të misionit ndërkombëtar, të pranishëm në Kosovë.

Nga vlerësimet që do t'i bëjë Kuvendi, varet se do të dalim më shpejt apo më ngadalë nga kjo situatë.

Hulumtimet do të tregojnë se si një protestë, sipas normave demokratike krejtësisht e ligjshme, me një motiv të protestimit kundër mbyetjes së tre fëmijëve në lumin Ibër dhe të bllokimit të rrugëve në Kosovë, u shndërrua në një protestë të dhunshme, me pasoja shumë të rënda. Organet përkatëse duhet të hulumtojnë se kush ishte i përzier në këto protesta dhe me çfarë qëllimi.

Nuk do të ketë sukses asnjë tendencë përçarëse, të ndarjes së Kosovës, enklavizimit apo të kantonizimit të territorit të saj.

**Kryetari** e hapi diskutimin për situatën aktuale në Kosovë.

**Alush Gashi**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, tha se duke riafirmuar të drejtën për protestë, fuqimisht e kundërshtojmë dhunën, ngase ajo nuk është përcaktim i shumicës së qytetarëve të Kosovës.

Angazhohemi për mbrojtjen e pakicave dhe të pronës së tyre. Mbrojtja e pakicave është përgjegjësi e shumicës, por nevojitet edhe vullneti i pakicave që të angazhohen për zhvillimin e Kosovës e jo kundër saj.

Për situatën e krijuar, gjatë këtyre ditëve në Kosovë, kërkojmë informacion zyrtar për tërë atë që është zhvilluar këtyre ditëve dhe ai informacion t'i paraqitet Kuvendit.

Kërkojmë të formohet një Komision Parlamentar ad hoc, për hulumtimin e shkaqeve për zhvillimin e ngjarjeve gjatë ditëve të shkuara.

Njollojja e tërë popullit të Kosovës nga disa qarqe është e prapanueshme dhe kundërproduktive. Përpjekjet që eskalimi i dhunës, të cilin e kundërshtojmë, të përdoret që çështja e statusit të Kosovës të mos zgjidhet drejtë, sipas vullnetit të qytetarëve të Kosovës është e rrezikshme.

Institucionet vendore dhe ato ndërkombëtare duhet të angazhohen në tejkalimin e kësaj situatë, në të mirë të paqes dhe të prosperitetit për të gjithë qytetarët e Kosovës, për një Kosovë të pavarur dhe demokratike.



**Hashim Thaçi** tha se zhvillimet e fundit janë shqetësuese. Reagimet që pasuan pas vdekjes mizore të tre fëmijëve në lumin Ibër, morën jetën e dhjetra qytetarëve dhe plagosjen e qindrave, u dogjën shtëpi dhe objekte fetare. Nga protestat paqësore eskaluan në trazira, ku në mesin e tyre pati individë që e përdorën dhunën, e cila është e palejueshme dhe e pajustificueshme.

Populli i Kosovës nuk është i dhunshëm, por ai ka halle të mëdha, të cilat kërkojnë zgjidhje të menjëhershme.

Ka edhe të atillë që nxitojnë që këtyre ngjarjeve t'u japin vlerësime të njëanshme. Ata nuk janë të interesuar të gjejnë zgjidhje, por vetëm t'i shpallin fajtorët. Kjo metodë policore është e papranueshme qëndrimet policore nuk mund të shndërrohen në vlerësime politike të institucioneve të Kosovës. Analiza e shkaqeve për këto ngjarje duhet të jetë e përbashkët, jo e njëanshme.

Në Kosovë ka krizë sociale dhe stagnim të zhvillimit ekonomik. Mbi 60 % e qytetarëve janë të papunë, pa mbrojtje adekuatë shëndetësore dhe mbi të gjitha me frikë se çfarë do të sjellë e ardhmja për ta.

Askund në botë nuk ka ndodhur që ata që kanë luftuar për çlirimin e vendit të vet, të lihen pa përkujdesje institucionale, siç po ndodhë në Kosovë me invalidët dhe veteranët e luftës. Institucionet janë me gjysmë kompetenca dhe çdo nismë për marrjen e përgjegjësive ngulfatet brutalisht, kurse në anën tjetër lejohet funksionimi i strukturave të paligjshme paralele të Serbisë, të cilat po përpiqen ta ndajnë një pjesë të territorit të Kosovës.

Edhe institucionet e Kosovës duhet t'a bëjnë një vetëkritikë punës së tyre. Përkundër kompetencave të kufizuara kanë mund të bëjnë më shumë për zgjidhjen e problemeve të qytetarëve.

Tani është koha për t'i riparuar dëmet e shkaktuara gjatë këtyre protestave dhe duhet të mbështetet Qeveria e Kosovës në planin e saj për sanimin e gjendjes.

Pakicat duhet t'i gëzojnë të gjitha të drejtat e tyre për të jetuar në një Kosovë të lirë dhe demokratike.

Duhet një dialog dhe bashkëpunim i mirëfilltë ndërmjet institucioneve të Kosovës dhe të bashkësisë ndërkombëtare, por ai bashkëpunim nuk nënkupton që ne të pranojmë rolin e ndonjë servisi.

Partneritetin me bashkësinë ndërkombëtare e kemi fituar me mund dhe nuk duhet të lejohet që ai të prishet. Çdo gur i hedhur mbi ushtarët e KFOR-it ose mbi miqtë tjerë ndërkombëtarë, është sulm mbi të ardhmen e Kosovës.

Kosovës e çliroam bashkarisht dhe bashkarisht do ta pavarësojmë.

**Bajram Kosumi** tha se javën e kaluar kanë ndodhur ngjarje për të cilat ende nuk kemi ndonjë pasqyrë të qartë. Ka filluar me një protestë, të motivuar drejt kundër funksionimit të strukturave paralele të Serbisë në Kosovë, kundër bandave kriminale që veprojnë në veriun e Kosovës, e cila më vonë është shndërruar në dhunë të pakontrolluar nga e cila ka pasur për pasojë njerëz të vrarë, të plagosur dhe djegie të pasurisë private dhe publike.

Grupi Parlamentar i AAK-së kërkon informacion të plotë nga përgjegjësit e UNMIK-ut dhe të KFOR-it se çka ka ndodhur javën e kaluar në Kosovë? Sa qytetarë janë vrarë, në çfarë rrethanash ata janë vrarë? dhe Kush i ka vrarë ata njerëz?

Ne duhet ta bëjmë një vijë ndarse ndërmjet dhunës që ka ndodhur dhe protestës së drejtë kundër gjendjes së krijuar në Kosovë.

Në Kosovë ka një progres të madh,por UNMIK-u së bashku me institucionet e Kosovës kanë bërë gabime me tolerimin e infrastrukturës së Qeverisë së Serbisë,që nga përfundimi i luftës,ato ende pa penguar operojnë në Kosovë.Ato kanë luajtur dhe ende vazhdojnë të luajnë rolin e luftënxitësit.

Por,në Kosovë ka ngecje dhe stagnim të zhvilit. Gjatë vitit 2003,shkalla e varfërisë ekstreme është rritur për 6%. Qytetarët e Kosovës,me të drejtë,kanë filluar ta humbin besimin në perspektivën e sigurtë të Kosovës.

Këtë krizë dhe këtë stagnim mund ta tejkalojmë nëse UNMIK-u,KFOR-i dhe institucionet e Kosovës bashkëpunjnë ndërmjet veti, sinqerisht dhe krijojnë një partneritet të ri.

Institucionet e Kosovës duhet të garantojnë më fuqishëm sigurinë e pakicave,e në veçanti të asaj serbe.

Bashkësia ndërkombëtare duhet të garantojë më fuqishëm se statusi përfundimtar i Kosovës do të zgjidhet në bazë të vullnetit politik të popullit të Kosovës.

**Gani Sadik** tha se ngjarjet e 17 dhe 18 marsit i kanë tronditur të gjithë,ngase askush pas pesë vjetësh në liri,nuk i ka pritur. Ato i luhatën marrëdhëniet me UNMIK-un dhe KFOR-in,të cilët kanë ardhur këtu më një mision shumë human dhe paqësor.

Ne duhet të gjejmë forcë dhe arsye ta kapërcejmë këtë gjendje dhe më lehtë t'i përmballojmë pasojat.

Duhet ta mbështesim vendimin e Qeverisë së Kosovës që ka ndarë mjete nga buxheti i Kosovës për rindërtimin e shtëpive dhe të obekteve të serbëve dhe të ashkalive që janë dëmtuar gjatë këtyre protestave.Ky është një vendim i drejtë i Qeverisë edhe pse ajo nuk e ka rindërtuar,nga buxheti i vet ,asnjë shtëpi të djegur të shqiptarve,turqëve dhe bošnjakëve nga forcat serbe gjatë luftës.

Ngjarjet e dhunshme duhet të denohen,ngase ato nuk janë mënyrë e zgjidhjes së problemeve.

Gjatë vlerësimit të këtyre ngjarjeve duhet pasur kujdes t'u ikim qëndrimeve që na ndajnë dhe armiqësojnë ndërmjet veti.

Kosova është e të gjithë qytetarëve të saj,pa dallim feje dhe përkatësie etnike.Dallimet tona duhet të jenë begati e Kosovës e jo shkas për mosdurim dhe urrejtje.

Komunitetet e tjera(joshqiptare dhe joserbe) do të përpiqen të bëjnë çka është e mundur për tejkalimin e kësaj suate dhe për zhvillimin e Kosovës dhe për të mirën e qytetarve të saj që të jetojnë me dinjitet dhe respekt reciprok.

**Opinionet,vërejtjet dhe propozimet e veta lidhur me gjendjen aktuale në Kosovë i dhanë edhe këta deputetë:Melihate Tërmkolli,Arsim Bajrami,Naim Maloku,Lulzim Zeneli,Muhamed Kelmendi,Mark Krasniqi,Xhavit Haliti,Hasan Meta,Faik Marolli,Shefki Sejdiu,Bislim Hoti,Ismajl Kurteshi,Sabit Rrahmani,Edita Tahiri,Smajl Latifi,Sala Ahmetaj,Sylejman Çerkezi,Fadik Geci,Drita Statovci dhe Sabri Hamiti,që i janë bashkangjitur transkriptit.**

Pas këtyre diskutimeve, Kuvendi nxori këto

**Përfundime:**

1. Kryesia e Kuvendit në bashkëpunim me kryetarët e grupeve parlamentare, në bazë të diskutimeve të sotme, duhet t'i hartojë përfundimet lidhur me situatën aktuale në Kosovë dhe t'ia paraqes Kuvendit në seancën e ardhshme për miratim;
2. Për seancën e ardhshme të ftohen: PSSP-së, z. Holkeri, komandanti i KFOR-it, z. Kamerhof, kryetari i Kosovës dhe kryeministri i Kosovës.

**Vazhdim i sancës më 1 prill 2004.**

Seancën e kryesoi **Fatmir Sejdiu**, anëtar i Kryesisë, kurse bashkëkryesues ishte **Nafije Gash**, anëtare e Kryesisë.

Kryesuesi konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 85 deputetë dhe e shpalli të hapur punën e saj.

Në fillim të seancës, kryesuesi i bëri një vështrim Rezolutës së Kuvendit të Serbisë, më të cilën kërkohet formimi i autonomisë për bashkësinë serbe në Kosovë. Ai tha se kjo paraqet një agresion kushtetues të Serbisë ndaj Kosovës dhe nxit tensione dhe jostabilitet. Kuvendi i Kosovës e kundërshton fuqishëm këtë rezolutë dhe çdo ndërhyrje të Serbisë në rregullimin e brendshëm të Kosovës.

**1. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për transportin e materieve të rrezikshme.**

**Kryesuesi** i informoi deputetët lidhur me proceduarit e shqyrtimit të këtij p/ligji si dhe për raportet dhe për rekomandimet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit Funkcional. Ai i hodhi në votë amendamentet e propozuara në këtë p/ligj, veç e veç.

Kuvendi i miratoi amendamentet 1,2,3,4,5,6,8,9,10,11,12,13,14,15,16,17,18,19,20,21a dhe 22, ndërsa nuk i miratoi amendamentet 7 dhe 21.

Në fund, **kryesuesi** e hodhi në votë P/ligjin në tërësi dhe rezultati ishte si vijon:

Për-----74;  
Kundër-----0;  
Abstenime-----0.

**Kryesuesi** konstatoi se Kuvendi i Kosovës, unanimitisht e miratoi Ligjin për transportin e materieve të rrezikshme.

## 2. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për veprimtaritë hoteliere dhe turistike.

Kryesuesi e ftoi propozuesin ta arsyetonte këtë P/ligj para deputetëve të Kuvendit.

**Ministri Ali Jakupi** e paraqiti materien që e normon ky P/ligj, objektivat që synohen të realizohen me të ,si dhe mënyrën e zbatimit të tij.

Pas arsyetimit të P/ligjit nga ministri Ali Jakupi, kryesuesi e hapi diskutimin për shqyrtimin e këtij p/ligji në parim.

**Opinionet, vërejtjet dhe sugjerimet lidhur me P/ligjin për veprimtaritë hoteliere dhe turistike i dhanë këta deputetë: Gani Prekopuca, Bujar Dugolli, Sabile Keçmezi-Basha, Ramadan Kelmendi, Drita Statovci dhe Besa Gaxheri, që i janë bashkangjitur transkriptit.**

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votë miratimin e këtij p/ligji dhe rezultati ishte si vijon:

Për-----74;  
Kundër-----0;  
Abstenime---0.

**Kryesuesi** konstatoi se Kuvendi i Kosovës e miratoi, në parim, P/ligjin për veprimtaritë hoteliere dhe turistike dhe i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin Funkcional ta shqyrtojnë këtë p/ligj brenda tri javësh dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet dhe rekomandimet për miratim.

## 3. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për energjinë.

**Kryesuesi** e ftoi propozuesin ta arsyetonte këtë P/ligj para deputetëve të Kuvendit.

Kryetari i Komisioni për Tregti dhe Industri, **Bajrush Xhemalji**, e paraqiti materien që e normojnë P/ligji për energjinë, P/ligji për rregullatorin e energjisë dhe P/ligji për energjinë elektrike. Ai theksoi se fushën që e normojnë këto tre p/ligje nuk është e normuar me ndonjë ligj tjetër dhe i arsyetoi objektivat që synohen të realizohen me këto tri p/ligje ,si dhe mënyrën e zbatimit të tyre.

Pas arsyetimit të P/ligjit nga kryetari i komisionit për Tregti dhe Industri, **Bajrush Xhemalji**, kryesuesi e hapi diskutimin për shqyrtimin e këtyre p/ligji në parim.

**Opinionet, vërejtjet dhe sugjerimet lidhur me P/ligjin për energjinë, P/ligjin për rregullatorin e enrgjisë dhe të P/ligjit për energjinë elektrike i dhanë këta deputetë: Fatmir Rexhepi, Gani Koci, Mahmut Bakalli, Ibush Jonuzi, Bedri Selmani, Gani Prekopuca dhe Ramadan Kelmendi, që i janë bashkangjitur transkriptit.**

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi i hodhi në votë miratimin e këtyre p/ligjeve, veç e veç dhe rezultati ishte si vijon:

**Për P/ligjin për energjinë:**

Për-----75;  
Kundër-----0.

**Për P/ligjin për rregullatorin e energjisë:**

Për-----75;  
Kundër-----0.

**Për P/ligjin për energjinë elektrike:**

Për-----75;  
Kundër-----0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi i Kosovës i miratoi, në parim, P/ligjin për energjinë, P/ligjin për rregullatorin e energjisë dhe P/ligjin për energjinë elektrike dhe i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin Funkcional t'i shqyrtojnë këto tri p/ligje brenda tri javësh dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet dhe rekomandimet për miratim.

#### **4. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për materialin fidanor.**

Kryesuesi e ftoi propozuesin ta arsyetonte këtë P/ligj para deputetëve të Kuvendit.

**Kryeministri, Bajram Rexhepi**, në të njejtën kohë e paraqiti materien që e normon P/ligji për materialin fidanor dhe P/ligjit për ndërmarrjet. Ai e arsyetoi përmbajtjen e këtyre p/ligjeve, objektivat që synohen të realizohen me këto p/ligje, si dhe mënyrën e zbatimit të tyre.

Pas arsyetimit të këtyre P/ligjeve nga kryeministri Bajram Rexhepi, kryesuesi e hapi diskutimin për shqyrtimin e P/ligjit për materialin fidanor.

**Opinionet, vërejtjet dhe sugjerimet lidhur me P/ligjin për materialin fidanor i dhanë këta deputetë: Tomë Hajdaraj, Sala Ahmetaj, Sebahate Krasniqi dhe Berat Luzha, që i janë bashkangjitur transkriptit.**

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votë miratimin e këtij p/ligji dhe rezultati ishte si vijon:

Për-----68;  
Kundër-----0.

**Kryesuesi** konstatoi se Kuvendi i Kosovës e miratoi, në parim, P/ligjin për materialin fidanor dhe i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin Funkcional ta shqyrtojnë këtë p/ligj brenda tri javësh dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet dhe rekomandimet për miratim.

#### **5. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për ndërmarrjet.**

Pasiqë **kryeminsitri, Bajram Rexhepi**, e kishte arsyetuar këtë P/ligj para deputetëve të Kuvendit, kryesuesi e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij në parim.

**Opinionet, vërejtjet dhe sugjerimet lidhur me P/ligjin për ndërmarrjet i dhanë këta deputetë: Bajrush Xhemajli, Haki Shatri, Berat Luzha, Naim Maloku, Ramadan Kelmendi, Xhelal Canziba dhe Hasan Meta, që i janë bashkangjitur transkriptit.**

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votë miratimin e këtij p/ligji dhe rezultati ishte si vijon:

Për-----shumica;  
Kundër-----0;  
Abstenime-----1.

**Kryesuesi** konstatoi se Kuvendi i Kosovës e miratoi, në parim, P/ligjin për ndërmarrjet dhe i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin Funkcional ta shqyrtojnë këtë p/ligj brenda tri javësh dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet dhe rekomandimet për miratim.

#### **6. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për njësit matëse.**

Kryesuesi e ftoi propozuesin ta arsyetonte këtë P/ligj para deputetëve të Kuvendit.

**Ministri Ali Jakupi** e paraqiti materien që e normon ky P/ligj, objektivat që synohen të realizohen me të, si dhe mënyrën e zbatimit të tij.

Pas arsyetimit të P/ligjit nga ministri Ali Jakupi, kryesuesi e hapi diskutimin për shqyrtimin e këtij p/ligji në parim.

**Opinionet, vërejtjet dhe sugjerimet lidhur me P/ligjin për njësit matëse i dhanë këta deputetë: Gani Prekopuca, Besa Gaxheri, Hatixhe Hoxha, Sebahate Krasniqi, Mahmut Bakalli, Blerim Baruti, Bajrush Xhemajli dhe Ibush Jonuzi, që i janë bashkangjitur transkriptit.**

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votë miratimin e këtij p/ligji dhe rezultati ishte si vijon:

Për-----62;  
Kundër-----0;  
Abstenime---0.

**Kryesuesi** konstatoi se Kuvendi i Kosovës e miratoi, në parim, P/ligjin për njësitë matëse dhe i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin Funkcional ta shqyrtojnë këtë p/ligj brenda tri javësh dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet dhe rekomandimet për miratim.

#### **7. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për standardizim.**

**Kryesuesi** e ftoi propozuesin ta arsyetonte këtë P/ligj para deputetëve të Kuvendit.

**Ministri Ali Jakupi** e paraqiti materien që e normon ky P/ligj, objektivat që synohen të realizohen me të, si dhe mënyrën e zbatimit të tij.

Pas arsyetimit të P/ligjit nga ministri Ali Jakupi, kryesuesi e hapi diskutimin për shqyrtimin e këtij p/ligji në parim.

**Opinionet, vërejtjet dhe sugjerimet lidhur me P/ligjin për standardizim i dhanë këta deputetë: Ibush Jonuzi, Berat Luzha, Naim Maloku dhe Blerim Baruti.**

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votë miratimin e këtij p/ligji dhe rezultati ishte si vijon:

Për-----62;  
Kundër-----0;  
Abstenime---0.

**Kryesuesi** konstatoi se Kuvendi i Kosovës e miratoi në parim, P/ligjin për standardizim dhe i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin Funkcional ta shqyrtojnë këtë p/ligj brenda tri javësh dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet dhe rekomandimet për miratim.

#### **8. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për marrëveshjet ndërkombëtare financiare.**

**Kryesuesi** e ftoi propozuesin ta arsyetonte këtë P/ligj para deputetëve të Kuvendit.

**Ministri Ali Sadria** e paraqiti materien që e normon ky P/ligj, objektivat që synohen të realizohen me të, si dhe mënyrën e zbatimit të tij.

Pas arsyetimit të P/ligjit nga ministri Ali Sadria, kryesuesi e hapi diskutimin për shqyrtimin e këtij p/ligji në parim.

**Opinionet, vërejtjet dhe sugjerimet lidhur me P/ligjin për marrëveshje financiare ndërkombëtare i dhanë këta deputetë: Fatmir Sejdiu, Ismajl Kurteshi, Bajram**

**Kosumi, Gani Prekopuca, Behxhet Brajshori dhe Bedri Selmani, që i janë bashkangjitur transkriptit.**

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votë miratimin e këtij p/ligji dhe rezultati ishte si vijon:

Për-----70;

Kundër-----0;

Abstenime---0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi i Kosovës e miratoi, në parim, P/ligjin për marrëveshje financiare ndërkombëtare dhe i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin Funkcional ta shqyrtojnë këtë p/ligj brenda tri javësh dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet dhe rekomandimet për miratim.

### **9. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese për emërimin e gjyqtarëve.**

Rekomandimin e këtij Komisioni, para deputetëve e arsyetoi Bajram Kosumi dhe i ftoi ata ta miratonin.

Ramadan Kelmendi t'heksoi se K PGJK nuk i ka respektuar rekomandimet e gjykatave komunale me rastin e propozimit të kandidatëve për gjyqtarë.

Pas shqyrtimit të rekomandimit të Komisionit Legjislativ për emërimin e gjyqtarëve, Kuvendi e miratoi këtë

## **V E N D I M**

1. Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, e miratoi propozimin e Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorial të Kosovës për emërimin e këtyre kandidatëve:
  1. Zyhdi Haziri, gjyqtar në Gjykatën Komunale në Gjilan;
  2. Miodrag Paviq, gjyqtar në Gjykatën Komunale në Gjilan;
  3. Naser Maliqi, gjyqtar në Gjykatën Komunale në Viti;
  4. Leorida Maloku, gjyqtare në Gjykatën Komunale në Gjakovë;
  5. Hevzi Murseli, gjyqtar në Gjykatën Komunale në Kamenicë;
  6. Daut Behrani, gjyqtar në Gjykatën Komunale në Gllogovc;
  7. Nurie Shala, gjyqtare në Gjykatën për Kundërvatje në Mitrovicë dhe
  8. Sabit Beqiri, gjyqtar në Gjykatën Komunale në Vushtri.

Kryesuesi e deklaroi të mbyllur seancën në orën 16:30 minuta.

Sekretaria e Kuvendit

Kryetari i Kuvendit të Kosovës  
Akademik Nexhat DACI